



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1724/6 prot.

Datë 10.06.2026

V E N D I M
Nr.782/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.06.2026 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër 1724/2026 prot., datë 02.06.2026, i operatorit ekonomik “A & E Engineering” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-84176-05-04-2026, me objekt “Mbikqyrje punime për objektin "Ndërtim dhe rikonstruksion rrugët Paskuqan 1,2", me fond limit 1,413,349.13 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues:

Operatori ekonomik “A & E Engineering” SHPK, me NIPT K72113010E, me adresa: Rruga Mujo Ulqinaku, Objekti Nr.23, Z.1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz.
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza”, nr. 492, Kamëz, Tiranë”, 4501, Lezhë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin

e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.05.2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-84176-05-04-2026, me objekt “Mbikqyrje punime për objektin “Ndërtim dhe rikonstruksion rrugët Paskuqan 1,2”, me fond limit 1,413,349.13 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 15.05.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 28.05.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Tesla Vizion	1.268.147,39	lekë	Kualifikuar
2H Studio	1.272.014,10	lekë	Kualifikuar
Bersant Ylli & XH & Miller	1.342.681,67	lekë	Kualifikuar
G B Civil Engineering	1,057,832.49	lekë	Skualifikuar
SRP Albanian Engineering	1,264,086.27	lekë	Skualifikuar
BN Project	1,256,608.71	lekë	Skualifikuar
A & E Engineering	11,251,749.61	lekë	Skualifikuar
IMES-D	1,266,060.25	lekë	Skualifikuar
Net-Group	1,265,581.97	lekë	Skualifikuar
ProStruct	1,258,481.69	lekë	Skualifikuar
BOE Leni-Ing & Angerba	1,265,229.38	lekë	Skualifikuar

Operatori ekonomik “A & E Engineering” shpk është skualifikuar nga autoriteti kontraktor me arsyen se:

“Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës nuk i është referuar njoftimit të bërë me nr. 5585 prot., datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përben shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufinjëve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim. - Faza: Kriter i përgjithshem”.

II.4. Në datën 29.05.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 02.06.2026 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2026/6746 dhe me nr. 1724/2026 prot, datë 02.06.2026 e operatorit ekonomik “A & E Engineering” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “A & E Engineering” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën

e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1724/1 prot, datë 04.06.2026.

II.7. Nëpërmjet shërbimit postar, është dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 6167/1 prot., datë 05.06.2026, me objekt “*Shkresë përcjellëse*” vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me nr. 6167 prot, datë 05.06.2026, (KSHA), protokolluar me tonën me nr. 1724/2 prot., datë 10.06.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “A & E Engineering” SHPK, mbi procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar vendimit të KSHA-së, rezulton se, kjo e fundit ka marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik “A & E Engineering” SHPK dhe në përfundim e ka refuzuar atë.

II.8. Në datën 10.06.2026, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik ankimues “A & E Engineering” SHPK, me shkresën nr.417 prot., datë 10.06.2026, me objekt “*Kërkesë për tërheqje nga çështjet administrative në ankesën Nr.Aplikimi online A/2026/6746 më datë 02/06/2026, me Nr. REF 84176-05-04-2026, me objekte: “Mbikqyrje punime për objektin “Ndërtim dhe rikonstruksion rrugët Paskuqan 1,2”, me fond limit 1,413,349.13 lekë pa TVSH, autoriteti kontraktor:Bashkia Kamëz”*”, protokolluar me tonën me nr.1724/3 prot., datë 10.06.2026, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit object ankimi duke u shprehur se: “*Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është duke u shqyrtuar ankesa Nr.Aplikimi online A/2026/6746 më datë 02/06/2026, lidhur me procedurën me Nr. REF 84176-05-04-2026, me objekte: “Mbikqyrje punime për objektin “Ndërtim dhe rikonstruksion rrugët Paskuqan 1,2”, me fond limit 1,413,349.13 lekë pa TVSH, autoriteti kontraktor:Bashkia Kamëz..* Bazuar në paragrafin e parë të nenit 117 të LPP-së deklarojmë dhe kërkojmë tërheqjen nga shqyrtimi i ankesës së paraqitur si më sipër cituar. *Kjo tërheqje bëhet për shkak të rishikimit të rrethanave dhe prioriteteve për këtë objekt specifik. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë dhe të procedoni me mbylljen e ankesës për objektin e sipërpërmendur”*.”

II.9. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113, të ligjit 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues, “A & E Engineering” SHPK, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-84176-05-04-2026, me objekt “Mbikqyrje punime për objektin "Ndërtim dhe rikonstruksion rrugët Paskuqan 1,2", me fond limit 1,413,349.13 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në datën 10.06.2026, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik ankimues “A & E Engineering” SHPK, me shkresën nr.417 prot., datë 10.06.2026, me objekt “Kërkesë për terheqje nga çështjet administrative në ankesën Nr.Aplikimi online A/2026/6746 më datë 02/06/2026, me Nr. REF 84176-05-04-2026, me objekte: “Mbikqyrje punime për objektin "Ndërtim dhe rikonstruksion rrugët Paskuqan 1,2", me fond limit 1,413,349.13 lekë pa TVSH, autoriteti kontraktor:Bashkia Kamëz”, protokolluar me tonën me nr.1724/3 prot., datë 10.06.2026, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi duke u shprehur se: “Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është duke u shqyrtuar ankesa Nr.Aplikimi online A/2026/6746 më datë 02/06/2026, lidhur me procedurën me Nr. REF 84176-05-04-2026, me objekte: “Mbikqyrje punime për objektin "Ndërtim dhe rikonstruksion rrugët Paskuqan 1,2", me fond limit 1,413,349.13 lekë pa TVSH, autoriteti kontraktor:Bashkia Kamëz..

Bazuar në paragrafin e parë të nenit 117 të LPP-së deklarojmë dhe kërkojmë tërheqjen nga shqyrtimi i ankesës së paraqitur si më sipër cituar.

Kjo tërheqje bëhet për shkak të rishikimit të rrethanave dhe prioriteteve për këtë objekt specifik. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë dhe të procedoni me mbylljen e ankesës për objektin e sipërpërmendur”.

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. KPP konstaton se, operatori ekonomik “A & E Engineering” SHPK, i cili ka paraqitur tërheqjen nga ankesa, është pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër 1724/2026 prot., për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave

për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, “A & E Engineering” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-84176-05-04-2026, me objekt “Mbikqyrje punime për objektin "Ndërtim dhe rikonstruksion rrugët Paskuqan 1,2", me fond limit 1,413,349.13 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik, “A & E Engineering” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

